



Pranimi / Dorezimi Primenje / Predaja Received / Delivery	30.03.2023	3	viti God Year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	In Prot In Prot Prot No	Shërbim Prilog Appendix	Sherma Kolicina Quantity
SKPMSTHCK	3044/2023		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.410/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.410/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 29.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.410/2023 e datës 24.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Formulari i datës 27.01.2023 për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2022 për ankuesin.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil, më datë 24.02.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimin së vlerësimi përfundimtar i punës është jo real, i padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa, Këshilli me datë 21.03.2023 ka pranuar vetëm shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2035/2023 të datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 27.01.2023; Shkresën për procedurat e njësisë së arkivit Ref. MPB/ARC/DPD/.../2018; Kërkesën për Arkivë pa datë dhe pa protokoll; Forma e dorëzimit dhe pranimit pa datë, pa protokoll dhe pa nënshkrim; Formularin për gjetjen e formave; E-mailin e datës 10.01.2023 nga ankuesja për E-mailin e datës 10.01.2023 nga J.S për ankuesen; E-mailin e datës 10.01.2023 nga ankuesja për E-mailin e datës 10.11.2022 nga ankuesja për , E-mailin e datës 23.01.2023 nga për ankuesen; E-mailin e datës 20.01.2023 nga ankuesja për , Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2397/2023 e datës 06.03.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 2841/2023 e datës 21.03.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 16.01.2023 për periudhën 01.01.2022 deri më datë 16.06.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 23.12.2020 Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 12.01.202; Akt Emërimit e datës 31.01.2013; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankueses e datës 05.01.2011; E-mailin e datës 20.03.2023 nga ankuesja për E-mailin e datës 19.08.2022 nga Ndryshimin i Aktit të Emërimit i datës 03.12.2021; Raportin për muajin dhjetor nga ankuesja i datës 30.12.2022; Raportin javor i datës 02.09.2022; Raportin për muajin korrik i datës 01.08.2022; Raportin për muajin nëntor i datës 01.12.2022; Raportin për muajin shtator i datës 03.10.2022; Raportin mujor i datës 02.11.2022; Raportin për vitin 2022 i datës 30.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil, dhe se e njëjta si Aktit të Emërimit me numër protokolli 750 të datës 03.12.2014 ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Arkivinimin e Dokumenteve*, në Drejtoratin për Prodhimin e Dokumenteve.

Me tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesja lidhur me vlerësimin e rezultateve ë punës për vitin 2022 është vlerësuar ndaras për dy periudhat e vitit, pasi që ka pas ndryshime të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt. Rrjedhimisht sipas Formularit të datës 16.01.2023, ankuesja është vlerësuar për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datë 16.06.2022, më notë të përgjithshme 4.13, ndërsa sipas Formularit të datës 27.01.202, e njëjta është vlerësuar për periudhën tjetër të vitit 2022 me notë të përgjithshme 3.87.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vlerësimit të rezultateve në punë sipas Formularit të datës 27.01.2023, pretendon së vlerësimi është jo real, i padrejtë dhe në kundërshtim më dispozitat ligjore.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimin në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues., rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesja për periudhën e parë të vitit 2022 lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizimit të objektivave të punës është vlerësuar më notë 4, ndërsa lidhur me pjesën e aftësive dhe shkathtësive profesionale është vlerësuar më notë 4.33, ku gjithsej nota e përgjithshme për këtë periudhë është 4.13. Kurse, për periudhën e dytë të vitit 2022, lidhur me përmbushjen e objektivave të punës është vlerësuar më notë 4, ndërsa për pjesën e aftësive dhe shkathtësive profesionale dhe vlerësuar më notë 3.67, ku gjithsej nota e përgjithshme e vlerësimit është 3.87.

Andaj, në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 në paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, nota përfundimtare e vlerësimit nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë", përkatësisht "shumë mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji konstaton se nuk është i bazuar pretendimi i ankueses së vlerësimi i punës për vitin 2022 sipas formularit të datës 27.01.2023 është i pa drejt dhe jo real, ngase mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendosjen e notës së përgjithshme 3.87 ka vlerësuar së ankuesja ka përmbushur dhe realizuar të gjitha objektivat e punës dhe së njëjta ka tejkaluar pritjet sipas këtyre objektivave.

Nisur nga faktet si me lart, Kolegji i Këshillit konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.410/2023

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.